



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 1119 Prot.

Tiranë, më: 09.09, 2020

Vendimi 05

**REFUZIM DEKLARATE MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI :**

Mos pajisjen me Deklaratë Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Personi juridik:** “ALDO INERTE” sh.p.k.

**Nr. NIPT-i:** L86329202G

**Adresa e selisë:** Rruga Sherishte-Drashovicë, Fshati Drashovicë, ZK: 3362, Nr.Pas.  
70/2, Selenicë, Vlorë

**Personi përgjegjës:** Krenar Mëhillaj

Për të zhvilluar projektin “**Shfrytëzimi i mineralit të gurit gëlqeror**”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

**Vendndodhja:** Zona Minerare 552/6, Objekti “Drashovicë”, Vlorë  
(*Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat*)

Bazuar në pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, më poshtë po listojmë:

**1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:**

*Drejtoritë teknike të ministrisë shprehin mendimin si më poshtë vijon:*

- Rekomandojmë mbajtjen parasysh të referencave ndaj ligjit të pyjeve dhe të dhënave kadastrale për pyjet dhe kullotat.
- Në raportin e thelluar të VNM-së subjekti nuk ka mbajtur parasysh të gjitha sugjerimet e bëra në fazën e njoftimit për çështjet që duhet të trajtonte në raportin e thelluar të VNM-së sa i takon menaxhimit të mbetjeve që do të gjenerohen gjatë zhvillimit të aktivitetit. Sugjerojmë të reflektohen të gjitha komentet e fazës së njoftimit.

**Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet:** Sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti, ndodhet jashtë zonës së mbrojtur dhe nuk prek asnjë Monument Natyre, por të kihet kujdes me gërryerjet, pasi në afërsi të zonës ndodhen “Monumenti i Natyrës - Rrepet e Drashovicës”.

**2. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:**

- Pranë zonës së shfrytëzimit kalon lumi i Shushicës. Nuk përshkruhen punimet për mbrojtjen nga erozioni, menaxhimi i sterileve me qëllim mos turbullimin e ujërave të lumit. Gjithashtu një përshkrim i detajuar i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit, ndihmon procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, duke bërë që zhvillimi i projektit të propozuar të përputhet me objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe normat e standardet mjedisore në fuqi.
- Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, nuk janë përshkruar masat konkrete i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**

  
**EDISON KONOMI**

**MINISTRI**

  
**BLENDI KLOSI**



1. Anex 1. Harta dhe koordinat

HARTA TOPOGRAFIKE ME KUFIJTE E ZONES MINERARE NR. 552/6, DRASHOVICE, VLORE  
Shk 1: 25 000

